



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1929/2 prot

Datë 16.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-03294-05-02-2024, me objekt: Loti 19 “*Erlotinib*”, me fond limit 18,629,073 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ankimues:** “Evita” SHPK, me NIPT (L31714005J), me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. Pasurie 7/120 – N1, Zona kadastrale 8270, Vol.28, Faqe 155, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me adresë: Rruga e Kavajës, Nr.1001, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** “Trimed” SHPK me NIPT (K51612031J), me adresë: Autostrada “Tiranë – Durrës”, Km.10, Zonë kadastrale 2105, Nr.pasurie 95/11, Kashar, Tiranë

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4326, datë 15.07.2024 dhe me nr. protokolli 1929/2024 datë 15.07.2024 e operatorit ekonomik “Evita” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-03294-05-02-2024, me objekt: Loti 19 “*Erlotinib*”, me fond limit

18,629,073 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 03.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, duke cituar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

[...]

*Rezulton se oferta e paraqitur nga OE Trimed është anomalisht e ulët [...].*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 16.07.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**